



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

Nr. 81/43 Prot.

Tiranë, më 24/09/2019

FTESË PËR OFERTË
me fond limit total 8,039 euro pa TVSH

“Blerje Sistemi VRA (Audiometria në fushë të hapur me stimulim viziv)

PROJEKT “EUSCREEN”

Universiteti i Mjekësisë Tiranë, në zbatim të projektit EUSCREEN, paketa ~~IP~~7, udhëhequr nga Universiteti Erasmus MC, Hollandë dhe financuar nga Komuniteti European sipas grantit Nr.733352.0., me objekt **“Implementation of cost-optimized childhood vision and hearing screening programmes in middle-income countries in europe”**, Referuar rregullores **“Commision Delegated Regula procestion (EU) No 1268/2012 of 29 October 2012 on the rules of application of Regulation (EU, Euratom) No 996/2012 of the European Parliament and of the Council on the financial rules applicable to the general budget of the Union.....”** në artikullin 137 Loë-value contracts (Article 104 of the Financial Regulation) , të **Ligjit nr.44, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në R.Sh”**, Urdhërin e blerjes nr.97, datë 08.09.2020 ,

Ju fton të paraqisni deri ofertën tuaj me objekt “Blerje Sistemi VRA” , sipas preventivit të mëposhtëm dhe specifikimeve teknike bashkëlidhur:

Nr	EMERTIMI	COP
1	SISTEMI VRA (Audiometria në fushë të hapur me stimulim viziv	1

Data e zhvillimit të tenderit do të jete **05/10/2020** ora **10:00**, prane Rektoratit të UMT-se, Rruga e Dibrës, kati i dyte, Sektori i Prokurimeve.

KRITERET DHE KUSHTET E OFERTES:

Operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë në një zarf të mbyllur prane autoritetit kontraktor plotësimin e dokumentave si më poshte:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

- **FORMULARIN E OFERTES.**

Shënim:

- - Çmimi dhe vlera të shprehen me 2 shifra pas presjes dhjetore.
- - Çmimi i kontratës do të konvertohet në Lekë sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate nga të dyja palët.

- **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojnë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv) ,
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

-

- KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);

b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;

c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike;

d. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore të vitit 2018, e cila duhet të jetë jo me pak se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet, për secilin vit.
- b) Kopje të vertetuar nga Administrata Tatimore të bilancit të vitit 2018.

2.2 Kapaciteti teknik:

- a) Shërbime të ngjashme dhe të së njëjtës natyrë të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit nga data e zhvillimit të tenderit, në një vlerë deri në 40 % e vlerës së përlogarit të kontratës që prokurohet.

Keto shërbime të së njëjtës natyre do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

Kur shërbimi i së njëjtës natyre është realizuar me entet publike, Operatori ekonomik do të vërtetojë duke paraqitur Kontraten e nënshkruar me entet, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e leshuar nga enti publik për realizimin e kësaj kontrate ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku shënohen datat, shumat e shërbimeve të realizuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

OSE

Kur shërbimi i së njëjtes natyre është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore të shitjes ku shënohen datat dhe shumat e shërbimeve të realizuara.

- b punonjes të certifikuar (minimalisht 1) në fushën e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit, me eksperiencë pune për shërbimet IT. Këto të vërtetohen me diplomat (në profilin elektronikë, informatikë ose telekom), CV dhe kontratat e punës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Kriteri I vlerësimit: Çmimi më i ulët i ofertës së përgjegjshme.

Afati I realizimit: do të jetë brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës.

ADMINISTRATORI
Andi MAHILA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Audiometër

Instrumenti i audiometrisë duhet të përfshijë:

- Instrumentin me sofëare diagnostikues
- Kufje audiometrike për matje në ajër konform normave: ISO 389-1 2017 dhe ISO 389-2 1994 ose ekuivalente
- Kufje për përcjellshmëri kockore (Bone Conductor) për matje kockore (nëmastoide) konform normave ISO 389-3 1994 ose ekuivalente
- Butoni i përgjigjes së pacientit

Të ketë të mundur matje në fushë të lirë konform normës: ISO 389-7 2005 ose ekuivalente

Duhet të jetë gjithashtu minimalisht konform klasifikimit të sigurisë: Klasa II, Lloji B
Audiometri duhet të përmbushë normat: Tone Audiometer: IEC 60645 -1 (2017), ANSI S3.6 (2010) ose ekuivalente

Të operojë minimalisht në rangun e temperaturave 15 - 35 °C dhe të ketë kohë minimale për të qënë gati për punë jo më shumë se 2 minuta.

Të jetë i pajisur me portë USB për tu lidhur me PC dhe me mundësi për tu lidhur shtet diagnostikuese audiometrike

Të jetë i pajisur me ekran me ngjyra me rezolucion të lartë jo më të vogël se 5 inch

Mundësi për maskim efektiv me zgjedhje automatike të një bande të ngushtë zhurme ose zhurme të bardhë

Teste të mundura: Speech nëpërmjet CD, MP3, Microphone or Ear, Stenger, Modified Hughson-Ëestlake

Monitorim nëpërmjet altropolateve të integruar, kufjeve ose altoparlanteve të jashtëm.

Rangu i frekuencës operative duhet të jetë afërsisht: 130 Hz to 8 kHz

Të ketë dalje minimalisht 7Vrms për altoparlante të jashtëm për të qënë e mundur për të krijuar zhurma deri në 90-100 dB (në 1 m largësi)

Të jetë i pajisur me memorie të brendshme për të paktën 40000 sesione.

Pajisja duhet të jetë e markuar CE sipas: Medical Device Directive 93/42/EEC

Duhet të plotësojë standartet e sigurisë: IEC 60601-1 2005/EN 60601-1 2006 dhe A1 2012, ANSI/AAMI ES60601-1:2005/(R)2012 ose ekuivalente

Sistem Altoparlantesh (set me dy altoparlante bashkë me aksesoret)

Altoparlant audiometrik me karakteristika si më poshtë vijon:

Me fuqi minimalisht 20 Ë rms

Përgjigjia në frekuencë të jetë në rangun afërsisht: 150 Hz - 8 kHz

Ndërtim me material druri ose MDF me karakteristika për të shmangur reflektimin e zhurmës

Të pajisur me burim ushqimi të aprovuar për përdorim mjekësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

Te jetë i pajisur me celës fikje-ndezje

Të pajisur me kablot me konektor kopatibël me audiometrin me sipër për lidhjen me Audiometrin me gjatësi minimalisht 3 m

Me hyrje për sinjale 0.5 – 7 Vrms

Raporti sinjal/zhurmë me shumë se 90 dB

Kuti VRA (2 Cope)

Sistem për ndihmë në diagnostikimin e humbjes së dëgjimit në fëmijët nga mosha 2 vjec e sipër

Sistemi duhet të shërbejë për të bërë fëmijët me bashkëpunues gjatë testimit

Sistem me lodra të lëvizshme dhe ndricim mundësisht LED i komandueshem me nje buton në largësi

Ndërtimi me material Druri ose MDF

Të përfshihen:

Burim ushqimit sipas standartit Shqiptar

Butoni i përgjigjes me kabell minimalisht 2 m te gjatë

Standarte sigurie që duhet të plotësojë konform normës: IEC 60601-1:2012 ose ekuivalente



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Euro



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
ADMINISTRATORI

DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në ftesen për oferte dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit _____

Nënshkrimi _____

Vula _____